



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2023:179809

Datë: 06.06.2024

Numri i dokumentit: 05792500

P.nr.2023:179809

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal, me gjyqtarin e vetëm gjykues Lulzim Paçarizi, si dhe sekretaren juridike Behije Karaçica, në çështjen penale ndaj të akuzuarit Sh.B, për shkak të veprës penale Posedimi i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.1 të KPRK-së, ndërsa sipas aktakuzës PP/II.nr.731/22 të dt. 01.06.2023, pas mbajtjes të shqyrtimit fillestar, të dt.31.05.2024, ku prezent ishin Prokuroria e shtetit Uridia Caka, i akuzuari Sh.B, me dt. 04.06.2024, shpallë, ndërsa me dt.06.06.2024, e përpilon këtë:

A K T G J Y K I M

I AKUZUARI: Sh.B, nga i ati Xh dhe e ëma Xh e lindjes G, i lindur më datën, në fshatin Randobravë komuna Prizren, ku edhe banon, me nr. personal:....., shqiptar, shtetas i R Kosovës, i pa martuar, ka të kryer shkollën fillore, punëtor privat, i gjendjes së dobët ekonomike.

Ë S H T Ë F A J T O R

Me datë.06.03.2023, rreth orës 21:20, në fsh.Retij, K.Rahovec, duke vepruar në kundërshtim me nenin 9 dhe 14 të Ligjit Nr.02/L-128 për Barnat Narkotike, Substanca Psikotrope dhe Prekusore, pa autorizim ka poseduar substancë narkotike të llojit kokainë, në atë mënyrë që derisa ishte duke lëvizur ne veturën e tipit "M" me targa, policia ju bën me shenjë që të ndalojnë, në ato momente gjersa drejtuesi i automjetit ishte duke e ndaluar veturën, i pandehuri nga dritarja e pasagjerit e hedh një kuletë ngjyrë të zezë brenda se cilës më pastaj janë gjetur katër qese najloni të mbushura me substancë në formë pluhuri, e cila më pas sekuestrohet nga ana e policisë dhe pas ekzaminimit laboratorik nga AFK ka rezultuar të jetë substancë narkotike e llojit kokainë me peshë të neto prej 1.17 gram.

- me këto veprime ka kryer veprën penale **Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge** nga neni 269 par. 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata konform nenit 4, 7, 17, 38, 39, 43, 46, 47, 48, 49, 69, dhe nenit 269 par.1, të KPRK-së si dhe nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, të njëjtin e shqipton:

G J Y K O N

Ashtu që e gjykon me dënim me gjobë **800 (tetëqind) euro**, të cilën shumë i akuzuari është i obliguar që ta paguaj në xhironlogarinë e kësaj gjykate në afat prej 30 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën nëse dënimi i shqiptuar me gjobë nuk paguhet në afatin e cekur, i njëjti do të zëvendësohet me dënimin me burgim në kohëzgjatje prej katër dhjete (40) ditëve, duke llogaritur çdo ditë të filluar burgimi me nga njëzet euro (20),

- si dhe me dënimin me burgim me kusht në kohëzgjatje prej **1 (një) viti**, ndërsa gjykata dënimin e shqiptuar me burgim nuk do ta ekzekuton në afatin kohor prej **2 (dy) viteve**, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale.

URDHËROHET Shërbimi Sprovues i Kosovës në Prizren që ta mbikëqyrë dhe ta ekzekutojë dënimin me kusht, ashtu që **OBLIGOHET** i akuzuari që të mbajë kontaktin me Shërbimin Sprovues të Kosovës në Prizren.

Konform nenit 269 par.3 të KPRK-së të akuzuarit i shqiptohet dënimi plotësues ashtu që i konfiskohet substanca narkotike e llojit Kokainë me peshë 1.17 gram.

Obligohet i akuzuari në emër të paushallit gjyqësor gjykatës t'ia paguajnë shumën prej 20 euro dhe në emër të viktimave të krimit shumën prej 20 euro, ndërsa shpenzimeve procedurale nuk ka pasur, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën ekzekutimi do të behet me detyrim.

A r s y e t i m

1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP/II.nr.412/23 të dt. 26.07.2023, e ka akuzuar Sh.B, për shkak të veprës penale posedimi i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, duke i propozuar gjykatës që pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar si dhe administrimit të provave, të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta dënoj në bazë të ligjit.

Gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me dt.31.05.2024, ku prezent ishin Prokuroria e shtetit Uridia Caka, i akuzuari Sh.B andaj ka pasur kushte për mbajtjen e shqyrtimit fillestar.

I akuzuari Sh.B deklorohet i fajshëm për veprën penale për të cilën ngarkohet, me vije keq për rastin i cili ka ndodhur, për të cilin jam penduar, kërkoj falje, po ashtu premtoj gjykatës që në të ardhmen do të jem më i kujdesshëm që të mos kryej kurrfarë vepre penale, kërkoj nga gjykata që në rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit të më shqiptohet një dënim sa më i butë, pasi që jam mbajtës i familjes.

Prokuroria e Shtetit Uridia Caka ka deklaruar: Nuk e kundërshton pranimin e fajësisë të bërë nga i akuzuari meqenëse i njëjti pranimin e fajësisë e ka bërë me vullnet duke e ditur natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë si dhe pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes, provat materiale dhe personale, në bazë të cilave është ngritur kjo aktakuzë e që nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike andaj i propozoj gjykatës që të aprovoj pranimin e fajësisë të bërë nga i akuzuari si dhe në rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit propozoj që për ketë të akuzuar gjykata si rrethane lehtësuese të ketë pranimin e fajësisë ndërsa si rrethane renduese dashjen e tij që të posedoj narkotik dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale të posedimit të narkotikëve, dhe i akuzuari të shpallët fajtor, të dënohet sipas ligjit si dhe të obligohet në kompensimin e shpenzimeve procedurale si dhe konform nenit 269 par.3 të KPRK-së propozoj që të konfiskohet substanca narkotike e përshkruar si ne dispozitiv të pikës III të aktakuzës.

2. Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, për shkak të cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nenin 242 të KPPRK-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatoj se i akuzuari i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i Shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

3. Gjendja faktike e vërtetuar.

Duke u bazuar në këto që u ceken me lart gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

-Se i akuzuari Sh.B ka kryer veprën penale posedimi i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjendjen e këtillë faktike e mori në tërësi ashtu siç ishte përcaktuar në aktakuzë dhe në provat të cilat i përmbante aktakuza, e ato janë;

- Raporti i oficerit V.K 2023-EB-111, dt.07.03.2023;
- Raporti i shpejtë 2023-EB-11, dt.06.03.2023;
- Raporti i ekspertimit nga Agjencia e Kosovës për Forenzik, AFK/2023-1067/2023-979, dt.11.05.2023;
- Vërtetim mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve, 2023-EB-11, dt.06.03.2023;
- Deklarata e dëshmitarit E.F e dhënë në polici, dt.07.03.2023;

- Deklarata e të pandehurit Sh.B, e dhënë në polici me dt,09.03.2023;
- Foto album , si dhe shkresat tjera në lëndë.

4. Elementet e veprës penale

Në nenin 269 par.1 të KPRK-së parashihet: *Kushdo që pa autorizim posedon narkotikë, substanca psikotrope apo analoge, dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tre (3) vjet.*

5. Vendimi i gjyqtarit të vetëm gjykues.

Duke u bazuar në këto që u ceken me lart gjyqtari i vetëm gjykues të akuzuarin Sh.B, e ka shpallur fajtor për veprën penale për të cilën ngarkohet, nga se në veprimet e tij të përshkruara si në dispozitiv të aktgjykimit, formohen të gjitha elementet e veprës penale shpërdorim i pasurisë së huaj nga neni 269 par.1, të KPRK-së, për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta gjykoj në bazë të ligjit, e me parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale : Posedimi i paautorizuar i narkotikëve substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.1 të KPRK-së, meqë me datë, vend dhe kohë siç është përshkruar hollësisht në dispozitiv të këtij aktgjykimi i akuzuari me veprimet e tij në kundërshtim me dispozitat ligjore ka konsumuar elementet e veprës penale të lartcekur. Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin, Gjykata vlerësoi rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, dhe gjeti si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë, pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale të kryer, kushtet e dobëta ekonomike, është mbajtës i familjes me punë ne sektorin e ndërtimtarisë dhe atë me punë sezonale, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata gjeti se i njëjti është recidivist pasi ka qenë i dënuar sipas Aktgjykimit p.nr.28/2017 të Gjykatës Themelore në Mitrovicë e i plotfuqishëm me datë 25.01.2018 (sipas të dhënave të evidences penale) dhe shkallën e përgjegjësisë penale të te akuzuarit. Gjykata është e bindur se edhe me një dënim të tillë, duke marrë parasysh edhe faktin se i akuzuari ka bërë pranimin e fajësisë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 38 të KPRK-ës, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të kryerjes së saj, që do të shërbej në parandalimin e kryerjes nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale), si dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7. Konfiskimi i substancës narkotike

Vendimi mbi konfiskimin e substancës narkotike është marrë konform nenit 269 par. 3 të KPRK-së.

8. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale.

Vendimi paushallin gjyqësor dhe shpenzimet e procedurës penale është marrë konform nenit 449 par.1 dhe 2 të KPPK-së, ndërsa vendimi në emër të kompensimit të viktimave të krimit është marr konform nenit 39 parg.3 nënparagrafi 3.1 të Ligjit nr.05/L036 për kompensimin e viktimave të krimit.

Me sa u tha me lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e konform nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal
P.nr.2023:179808, dt.04.06.2024.

Sekretarja juridike
Behije Karaçica

Gjyqtari i vetëm gjykues
Lulzim Paçarizi

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, nëpërmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.